



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prifilato Received/Delivry	05.05.2021	1	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SH/02	2205/2021		116.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.158/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.158/2021 të datës 19.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Martin Dushi", p.n, Komuna e Klinës, kundër Vendimit KA.nr.10/2021 të datës 19.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si bazuar** ankesa me numër A.nr.158/2021 e datës 19.03.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet** Konkursi i brendshëm Nr.02/2020 për pozitën e punës Referentë i Lartë në Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Klinë, i shpallur me datë 11.12.2020, nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- III. Shfuqizohet** Vendimi KA.nr.10/2021 i datës 19.02.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- IV. Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatim e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

10.01.2020 për B.N; Kërkesën për punësim të ankuesit; Diplomën e ankuesit; Vendimin nga Kolegji AAB për ankuesin; CV-në e ankuesit; Procesverbalin e datës 15.04.2017; Certifikatat për ankuesin; Kërkesën për transferim të brendshëm e datës 19.08.2020 e ankuesit; Letër reference për ankuesin e datës 17.12.2020; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për ankuesin dhe Përgjigjen në ankesë e datës 13.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar,*
sepse:

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 11.12.2020 ka shpallur konkursin e brendshëm Nr.02/2020 për plotësimin e pozitës Referentë i Lartë në Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Klinë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, dhe i njëjti është përfshirë në listën e shkurtër dhe ka vijuar fazën e testimit me shkrim dhe me gojë. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 11.01.2021 ka publikuar njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare, në bazë të të cilit ankuesi nuk rezultoi kandidat i suksesshëm.

Ankuesi kundër njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare, më datë 05.02.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 19.02.2021 ka nxjerr Vendim KA.nr.10/2021 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar dhe ka lënë në fuqi njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare, të datës 11.01.2021.

Kundër Vendimit KA.nr.10/2021 të datës 19.02.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ankuesi me datë 19.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe juridike, sepse i njëjti pretendon se: Pozita Referent i Lartë duhet të ketë përvojë të punës prej dy vitesh pas diplomimit ndërsa kandidati i përzgjedhur ka diplomuar në shtator të vitit 2020, në këtë rast nuk posedon njohuri të specializuara të fituara përmes universitetit: Testi me shkrim ka përmbytur gjithsejtë 29 pyetje, ndërsa neni 36 i Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përcakton se testi me shkrim për kandidatët përmban 30 deri 50 pyetje; Rezultati i kandidatit të suksesshëm është shpalla më datë 11.01.2021 ndërsa testimi është mbajtur më datë 28.12.2020 që është 6 ditë pas afatit; Shpallja dhe zhvillimi i procedurës është bërë në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr.21/1012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, e të cilat janë shfuqizuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë; Me tutje ankuesi pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse nuk ka shqyrtuar drejtë pretendimet ankimore.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se për pozitën e punës Referent i Lartë në Gjykatën Themelore, kandidati duhet të ketë përvojë të punës prej dy vitesh, pas diplomimit, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas shqyrtimit të provave të lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, ka konstatuar se pretendimi ankimor është i bazuar, sepse: Kolegji duke iu referuar

konkursit të brendshëm Nr.02/2020 të shpallur me datë 11.12.2020, për pozitën e punës Referent i Lartë në Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Klinë, ka konstatuar se kriteret e konkursit për këtë pozitë të punës kanë qenë: *Diplomë universitare, Fakulteti Juridik e nevojshëm; Dy (2) vite përvojë pune e nevojshme*. Ndërsa duke iu referuar shkresave të lëndës, respektivisht Diplomës Nr.119/20 të datës 07.08.2020, të lëshuar nga Bartësi Privat i Arsimit të Lartë, Kolegji "Biznesi", është konstatuar se kandidati i përzgjedhur, ka përfunduar Fakultetin Juridik me datë 23.07.2020, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se i njëjti nuk e ka plotësuar kriterin e përvojës se punës, dy (2) vjeçare, siç kërkohet në konkurs, sepse për pozitat profesionale siç është pozita Referent i Lartë, përvojë e punës njihet vetëm përvoja e fituar pas diplomimit në fushën respektive, të përcaktuara në konkurs. Njohja e përvojës se punës vetëm pas diplomimit në fushën përkatëse është konfirmuar edhe me Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.77/2019 të datës 10.06.2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Andaj, bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në kuadër të Sekretarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë dhe përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullores 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 28 ku përcaktohet se: 1. *Anëtarët e KPSHC- së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim; 1.1. Arsini dhe Kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës; 1.3 Shikathtësia dhe aftësitë' dhe 1.4 Elementet tjera te meritës*. Rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 11 paragrafin 1 ku përcaktohet se: *Pranini në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar*.

Ndërsa, pretendimi ankimor lidhur me përmbajtjen e testit me shkrim, nuk qëndron sepse me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 36 përcaktohet se: 1. *Testi me shkrim për kandidatet përmban 30 deri 50 pyetje, ndërsa përbehet prej këtyre pjesëve; 1.1 Pjesa e njohurive të përgjithshme. Në këtë pjesë kandidateve u parashtrihen 3 deri 5 pyetje në formë eseje; 1.2 Pjesa e aftësive të përgjithshme. Në këtë pjesë kandidateve u parashtrihen 10 deri 15 pyetje me përgjigje të shumëfishta; 1.3 Pjesa e njohurive që lidhet me vendin e punës. Në këtë pjesë kandidateve u parashtrihen 15 deri 23 pyetje, të cilat janë 50% me përgjigje të shumëfishta dhe 50% në formë eseje; 1.4 Pjesa e njohurive për gjuhë të huaja. Kjo pjesë zhvillohet për kandidatet të cilët konkurrojnë për pozita ku kërkohet njohuri e gjuhëve të huaja. Në këtë pjesë kandidateve u parashtrihen prej 5 deri 7 pyetje me përgjigje të shumëfishta dhe dy ese për të testuar fjalorin, gramatikën, sintaksën dhe kuptimin e teksteve të shkruara në një gjuhë të huaj*. Andaj, në kuptim të kësaj rregullore, Kolegji vlerëson se testi me shkrim duhet t'i përmbajë 50 pyetje nëse aplikohen katër pjesët e testimit, duke përfshi edhe pjesën e njohurive të gjuhëve të huaja, mirëpo në rastin konkret, meqenëse nuk ka qenë kriter i konkursit njohja e ndonjë gjuhe të huaj, Kolegji vlerëson se nuk ka qenë i nevojshëm testimi i kandidateve lidhur me njohjen e gjuhëve të huaja. Ndërsa është në diskercion të Komisionit Përzgjedhës, të përcaktojë numrin e pyetjeve në përputhje me kriterin e përcaktuar me nenin 36 nen paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që në këtë rast, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar drejtë, dhe se pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i papranueshëm.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se rezultati i kandidatit të suksesshëm është shpallur jashtë afatit ligjor, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 41 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se organi i punësimit *rezultatit e procedurës se rekrutimit duhet të publikoje brenda 7 ditëve pas përfundimit të procedurës se rekrutimit*. Mbi këtë bazë ligjore, pretendimi ankimor i ankuesit është i pa pranueshëm, sepse, bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se Komisioni Përzgjedhës me datë 28.12.2020 ka përgatitur raportin final për rekomandimin e kandidatit të suksesshëm, ndërsa publikimi i rezultatit është bërë me datë 11.01.2021, brenda afatit prej 7 dite pune. Kolegji këtë konstatim e ka mbështetur në faktin se afati ka filluar të rrjedh nga data 29.12.2020, ndërsa data 1, 2, 4, 7, 9 dhe 10 janar 2021 ka qenë dite pushimi për shkak të festave zyrtare dhe ditëve të vikendit, në të cilat dite nuk ka qenë ditë pune për organin e punësimit, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se shpallja dhe zhvillimi i procedurës se rekrutimit është bërë në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve civil, të cilat janë shfuqizuar me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave duke iu referuar Aktgjykimit në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike nuk zbatohet në raport me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përderisa cenohet pavarësia funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetute*. Po ashtu, me të njëjtin aktgjykim është shfuqizuar nenin 85 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e që nënkupton se Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është i zbatueshëm për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit mbi këtë bazë është i papranueshëm.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.10/2021 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, duke përfshirë edhe pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me përvojën e punës të kandidatit të përzgjedhur, nuk ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 si dhe nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.158/2021

Avdyll BEKTESHI

Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Jeton KOÇA

Jeton
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesii
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

